Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur anëtarë të familjes,

Ky kapitull në matematikë i kushtohet *gjeometrisë transformative*. Do të mësojmë katër shndërrimet bazë që mund të pësojnë objektet dy-dimensionalë: pasqyrimet (përmbysjet), rrotullimet, zhvendosjet (rrëshqitjet nga një vend në tjetrin) dhe zgjerimet (bymimet ose tkurrjet). Duke përdorur këto shndërrime, objektin mund ta zhvendosim, t'i ndryshojmë pozicionin, ose ta vëmë sipër një objekti tjetër të së njëjtës formë. Do të mësojmë si t'i dallojmë këta tipa shndërrimesh, do t'i përshkruajmë dhe do të krijojmë figura simetrike me anë të tyre.



Disa nga zbukurimet ose disenjot që shohim në bordura, letra muresh, tapiceri, batanije dhe stofra krijohen pikërisht duke kombinuar shndërrime të tilla.

Fjalor Disa terma të rinj me të cilët do të ndeshemi këtë kapitull.

zgjerim	**pasqyrim sipas një vije**	**faktor përpjesëtimor**
imazh	**simetri pasqyruese**	**shndërrim**
vijë e pasqyrimit	**rrotullim**	**shvendosje**
vijë e simetrisë	**simetri e rrotullimit**	**vektor**
Mesore pingule	**Vizatim përpjesëtimor**	

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Në klasë, nxënësi do të krijojë figura nëpërmjet shndërrimeve. Mund t'i kërkoni nxënësit që t'ju tregojë disa të tilla. Gjithashtu, përpiquni të gjeni zbukurime ose figura që përmbajnë simetri ose kombinime imazhesh të zgjeruara në ndërtesa, letra muresh, batanije, jorgane dhe vende të tjera në shtëpi dhe në lagjen tuaj. Do të çuditeni kur të shihni se sa të tilla ekzistojnë!